



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/4-25453/2026
Kaçanik, 18.09.2026

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 25.09.2026 (e premte), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



Në mbledhjen e VII (shtatë) të Rregullt të KPF të datës 25.09.2026, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti Gjashtëmujor i KKSBB për periudhën janar- qershor;
3. Propozim-vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 - për shqyrtim dhe aprovim;
4. Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025
5. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluashtëshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluashtëshme të Komunës;
7. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025-2026;
8. Informatë fillimi i vitit të ri shkollor 2026-2027 në Komunën e Kaçanikut;
9. Plani Komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut;
10. Propozim Vendim për Miratimin e raportit përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshërit;



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.060/01-18158/26
Kaçanik, 23.04.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e 8 e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 27.07.2026, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e takimeve, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Selajdin Troni, Lejla Muhaxheri-Çaka, Bashkim Krasniqi, Kadrije Lika Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli.

Nga Ekzekutivi i Komunës: Nënkrjetari i Komunës- Xhelal Dema, Drejtorët e Drejtorive. Nga zyrtarët: Asistentja e Kryesuesit, Zyrtarja për Marrëdhënie me publikun - Kabineti i Kryetarit

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Arianita Bajrami – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 7 anëtarët-të gjithë, materialin e keni marrë, e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të KPF-së për vitin 2026, data 27.07.2026, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;
3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026;
4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;
5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025.

6. Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;
7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajjtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
8. Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajjtëshme të komunës;

Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajjtëshme të komunës

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin, nëse nuk ka dicka atëherë e hedhim në votim: 7 për; anjë kundër dhe asnjë abstenim. Me këtë rast konstatoj se Komiteti për Politikë dhe financa

APROVOJ

Rendin e punës prej 9 pikave- të përcaktuara si në ftesën për mbledhje.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Ernesta Krasniqi: Në procesverbal mungon debati mes nesh kryesues, unë nuk e di pse nuk është shënuar fjala ofenduese ndaj nesh të cilën e ka thënë kryesuesi, unë kërkoj që të shënohet, fjalët që fliten në Komitet duhen të shënohen, unë e kam edhe videon të cilën ke thënë edhe ti vetë shënoje, shkak që nuk është në transmetim live, e për me qenë korrekt ndaj qytetarëve duhet të shënohet cdo gjë.

Selajdin Troni: Pasi që nuk është live pse ke ba video ti? A është e drejte ti me ba video? Për të drejtë e shikon tjetër kush.

Ernesta Krasniqi: Në momentin që unë e kam nxjerr telefonin kam tregu që po bëj video sepse e kam ditë që fjalët nuk do të shënohen.

Kadrije Lika Troni: Njejtë edhe unë si Ernesta jam e shqetësuar që pse fjalët që fliten këtu nuk evidentohen në transkriptë, lidhur me fjalën tënde kryesues që thua “ju na keni thënë neve kriminel” besoj se të gjithë jeni këtu e dini që nuk janë thënë kurrë këto fjalë. Plus nga OSCE nuk kemi pasë askënd për vrojtim, mungesa e mosevidentimit meniher na tregon këtë, ose ne i mbajmë mbledhjet live, jap ide që duhet të mbahen live, mbledhjet janë publike, ne jemi komiteti më i lartë në Komunë, e këtu me mungu fjalët nuk janë të evidentuara. Ne e votojmë procesverbalin me plotësim ndryshime.

Bashkim Krasniqi: Sa i përket proceverbalit atë ditë, unë mendoj që nëse edhe atë ditë kishi folë sikur sot, e nuk hinit e dilnit e bertisnit se përbesë as unë skam mujt me ju kuptu, keni fol përnjëherë, përderisa flisni kështu e nuk shënohen besoj që mundeni me u anku nëse nuk janë shënu.

Kadrije Lika Troni: Po më vjenkeq që ti nuk e ke pasë koncentrimin me na dëgju se

keni qenë tu bashkebisedu mes vete, ju se mani qetësinë vetë e ankohi pse nuk na keni dëgju, unë smundem me thanë dëgjonani cka po bisedojmë. Nëse ju vendosni për pikën 4 me e vendos në kuvend ne kemi thënë se e lëshojmë mbledhjen. Në momentin që ne jemi ngritë në këmbë për këtë çështje kryesuesi e ka thënë atë fjalë, ai ska drejtë me i ofendu anëtarët e komitetit, po mvjen keq që po të them po ti duhesh me kërku falje për këtë, qysh ki me mbajtë mbledhje kur nuk je shembull për tjerët, unë nuk i shkeli procedurat e ligjet, e ti thu ju ktu jeni krejt bud*ll, po tbetohna nzot se e ke thanë, trego a e ke thanë

Selajdin Troni: Po qe ty nuk du me ta thanë, ernesta sa herë ka thënë turp të qoftë, ti nuk po din me udhëheqë mbledhjen asniher nuk kam thënë asgjë.

Bashkim Krasniqi: Ju aq shumë provokoni, paragjykoni, jo sdin me lexu jo sa u gove nga gjumi, që me i dal një fjalë që sduhet e ju me e ba atë fjalë skandal, sinqerisht jam duke ju thënë. Zhurmat e juaja janë bërë të padurueshme për veshët, unë e kuptoj që për shkak se po bëhen shumë punë të mira në komunë ju e keni këtë se nuk mundeni me i plasu në internet e po bëni këso skandale.

Ernesta Krasniqi: Kur kryesuesi e ka thënë fjalën unë kam qenë ulur, dhe kam bisedu me Makfiren, kryesuesi insistojke tek makja që me e shkru fjalën, edhe ajo e din edhe e ka dëgju se jemi kan ulur, une kur jam qu kam ec, Makja i ka thënë kryesuesit se eshte gabim me e shkru, sështë gabim me shkru është gabim me thënë, plus e ka të regjistruar se është thënë fjala edhe për akuzën që ka thënë na keni thene jeni kriminel, unë këtë gjë nuk e kam thënë askund këtë fjalë e as në platëforma sic i përcjell kolega. Momentin kur unë kam thënë për një pikë që duhet me e largu nuk dëgjon asnjëherë me gjasë pse të vjen fjala nga unë apo kur të erdh shpregimi nga kryetari e kuptove.

Selajdin Troni: Kryetari në punën time ska nevojë me u përzi, unë kam desht me i mbajtë pikat e me i lexu, pastaj me vendosë me e largu, është mirë me më kursy edhe mu pak nga gabimet sepse jam i ri në këtë pozitë.

Ernesta Krasniqi: është mirë me i dëgju këshillat prej krejtve edhe më e rëndësishmja që procesverbali me u shënu saktë nëse në klëtë mbledhje nuk bëhet rregullimi i procesverbalit atëherë e vë në dyshim cdo gjë këtu, unë nuk mundem me i mbajtë mend se cka flasin gjithë kolegët, unë hi e lexoj me ditë cka kanë diskutu edhe kolegët e tjerë, nëse vazhdojmë me e largu cka sna pëlqen e me shtu çka na pëlqen kjo sështë në rrëgull.

Ardita Rrahmani: është torturuese prej secilit prej nesh me dëgju të njejtat gjëra, zonjat kanë të drejtë me votu pro ose kundër, unë herën e kaluar nuk kam dëgju asgjë sinqerisht, njëra tek dera njëra ulur ktu, ska pasë hapsirë më diskutu asgjë, Ernesta tlutna një këshillë, bile ktu tkemi konsideratë, Mbledhjet e KPF me ligjin për vetëqeverisje mbahen pa kamera. Pushteti për momentin është në anën tuaj, bëhuni si grup e qojeni në ministrinë përkatëse që mbledhjet të mbahen me kamera, e para nuk është hiq respekt, se unë e di që nuk ki respekt për oponentët politik, por nuk ta jap drejtën e botës, me inqizu në një ambient në të cilin nuk lejohet kjo gjë e kryesuesi është tregu tolerant e ka bërë, e nëse je për me ndryshu ligjin unë jam me ty. Kjo është dhunë dhuna nuk është veq me të mshume, unë nuk e di qysh isha ballafaqu në të njejtën situatë, e meta ime është që tonin e kam që dukem si tu u rreh po nuk jam. Ekziston një email ku kam kërku që të gjitha fjalët të përfshihen. Jam kundër secilës fjalë ofenduese, ju spo jepni hapsirë për diskutim.

Ernesta Krasniqi: A po doni me diskutu, a jeni të gatshëm me diskutu, pasi që në procesverbal shënon se ne kemi lëshuar mbledhjen, nuk ekziston anjë fjali nga dikush që po dënohet gjuha e përdorur nga kryesuesi, ose nga kolegët e tjerë, është në pikëpyetje a është thënë.

Salajdin Troni: Kush është pro procesverbalit, pa plotësim-ndryshime?
5 pro, 2 kundër, asnjë abstenim, atëherë konstatoj se KPF:

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes se VI të KPF të datës 26.06.2026/ Lënda: 01Nr.60/01-14615/26

2. Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026;
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025.
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

6. Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

8. Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës;
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

9. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: E hapi diskutimin, për diskutim nuk u paraqit askush, pika hidhet në votim, u votua njëzëri, dhe KPF konstaton se:

APROVOJ

**Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim
afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës
I rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:43. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 06 anëtarë, me herët shkoj Lejla Muhaxheri-Çaka.

Mbledhja e VII (shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës e vitit 2026 e legjislaturës së 8, do të mbahet me 27.07.2026 (e enjte) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Arianita Bajrami

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni



Republika e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

I	Data	09.09.26	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	001		104/02-24608	1

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – KKSBB

RAPORT 6-MUJOR I PUNËS

PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2026

I. HYRJJE

Ky raport paraqet aktivitetin dhe çështjet kryesore të trajtuara nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) i Komunës së Kaçanikut gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026. Raporti është hartuar në bazë të tri procesverbaleve të mbledhjeve të KKSBB-së, të mbajtura më 25 shkurt, 28 prill dhe 9 qershor 2026.

Gjatë kësaj periudhe, KKSBB ka shërbyer si forum për bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve komunale, Policisë së Kosovës, FSK-së, institucioneve arsimore, organizatave dhe përfaqësuesve të komunitetit, me qëllim identifikimin dhe adresimin e çështjeve që ndikojnë në sigurinë në bashkësi.

II. MBLEDHJET E MBAJTURA

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur tri mbledhje të KKSBB-së:

1. Mbledhja e parë – 25.02.2026;
2. Mbledhja e dytë – 28.04.2026;
3. Mbledhja e tretë – 09.06.2026.

Në mbledhjen e parë u konstatua kuorumi dhe u miratua rendi i ditës. U emërua koordinatori i KKSBB-së, z. Gazmend Bunjaku, dhe u diskutua gjendja e sigurisë në komunë. Për janar 2026, Policia raportoi 36 raste, prej të cilave 29 vepra penale dhe 7 raste kundërvajtëse. Ndër rastet e përmendura ishin lëndimi i lehtë trupor, armët, mashtrimi, sulmi, vjedhjet, dëmtimi i pronës, kanosja, narkotikët, dhuna në familje dhe keqtrajtimi i fëmijëve.

Në këtë mbledhje u formua edhe grupi punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së KKSBB-së për vitin 2026.

Në mbledhjen e dytë, gjendja e sigurisë u vlerësua përgjithësisht e qetë, ndërsa u trajtuan raste të dhunës në familje, kanosjeve dhe përdorimit të narkotikëve. Vëmendje e veçantë iu kushtua sigurisë në shkolla, dhunës dhe bullizmit, përfshirë bullizmin online, mekanizmave anonimë të raportimit, trajnimit të mësimdhënësve dhe vetëdijesimit të nxënësve e prindërve.

Gjithashtu u diskutua funksionalizimi i kamerave të sigurisë, dëmtimi i objekteve fetare, parkimi dhe bllokimi i trotuareve, si dhe siguria e fëmijëve dhe komunikimi me institucionet sociale.

Në mbledhjen e tretë, situata e sigurisë u vlerësua e qetë dhe pa raste serioze që kanë cenuar sigurinë e qytetarëve. U theksua se Policia kishte angazhim të shtuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe se rastet kriminale, sipas përfaqësuesit policor, kishin shënuar rënie.

Tema kryesore e kësaj mbledhjeje ishte siguria në trafikun rrugor dhe hapësirat publike. U diskutuan ndriçimi publik, sinjalizimi rrugor, shpejtësia pranë shkollave, parkingu pranë çerdhes, kanalizimi, punimet në Çarshinë e Vjetër, zhurma nga lokalet, përdorimi i trotinetëve nga fëmijët dhe gatishmëria për sezonin veror.

III. VLERËSIMI I GJENDJES SË SIGURISË

Nga diskutimet dhe raportimet e bëra në tri mbledhjet e KKSBB-së, gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është vlerësuar përgjithësisht e qetë dhe e menaxhueshme. Megjithatë, janë evidentuar disa fusha që kërkojnë vëmendje dhe angazhim të vazhdueshëm institucional.

Ndër çështjet kryesore të identifikuara janë: dhuna në familje, përdorimi dhe shpërndarja e narkotikëve, dhuna dhe bullizmi në shkolla, bullizmi online, braktisja e shkollës, siguria në komunikacion, parkimi dhe bllokimi i trotuareve, zhurma gjatë natës, qentë endacakë dhe kapacitetet e Shërbimit të Zjarrfikësve.

IV. SIGURIA NË SHKOLLA DHE MBROJTJA E FËMIJËVE

Siguria në shkolla ka qenë një nga temat më të rëndësishme të trajtuara gjatë periudhës raportuese. KKSBB ka theksuar nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet Policisë së Kosovës, Drejtorisë së Arsimit, shkollave, prindërve dhe institucioneve sociale.

Është diskutuar veçanërisht dukuria e bullizmit, përfshirë bullizmin online, si dhe mungesa e raportimit të disa rasteve. Është propozuar krijimi i një mekanizmi anonim të raportimit, formimi i një ekipi ndërinstitutional dhe hartimi i një plani veprimi kundër bullizmit. Po ashtu është kërkuar vazhdimi i trajnimeve për stafin arsimor dhe aktivitetet vetëdijesuese për nxënësit e prindërit.

Në procesverbal është evidentuar edhe shqetësimi për katër raste të braktisjes së shkollës gjatë vitit, duke kërkuar trajtim institucional të tyre.

V. SIGURIA NË TRAFIK DHE HAPËSIRAT PUBLIKE

Në mbledhjen e tretë u trajtuan një numër çështjesh që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë në trafikun rrugor dhe hapësirat publike. U ngrit nevoja për përmirësimin e ndriçimit publik dhe sinjalizimit rrugor, si dhe për identifikimin e pikave të rrezikshme.

U paraqit kërkesa për vendosjen e një pengese të shtrirë në rrugën “Vëllezërit Çaka”, afër shkollës në fshatin Bob, për shkak të shpejtësisë së automjeteve. Gjithashtu u diskutua gjendja e komunikacionit dhe parkimit pranë çerdhes së fëmijëve, ku është kërkuar rritja e sigurisë për fëmijët dhe prindërit.

U diskutua edhe nevoja për vazhdimin e aktiviteteve parandaluese lidhur me fëmijët që përdorin trotinetë në rrugë dhe hapësira publike.

VI. GATISHMËRIA PËR EMERGJENCA DHE SEZONIN VEROR

KKSB ka trajtuar edhe gatishmërinë e institucioneve të sigurisë për sezonin veror. Policia e Kosovës ka njoftuar se ka përgatitur plan operativ për sezonin veror, ndërsa Shërbimi i Zjarrfikësve ka planin e vet operativ. Është evidentuar nevoja për kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe teknike, veçanërisht për shkak të mungesës së stafit në Shërbimin e Zjarrfikësve.

Në këtë kuadër është vlerësuar e nevojshme që institucionet të vazhdojnë bashkëpunimin dhe koordinimin gjatë periudhave me fluks të shtuar të automjeteve dhe qytetarëve, si dhe në parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve.

VII. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Një element i përbashkët i të gjitha mbledhjeve ka qenë rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitutional. Në punën e KKSBB-së kanë marrë pjesë përfaqësues të Komunës, Policisë së Kosovës, FSK-së, arsimi, HANDIKOS-it, Kryqit të Kuq, bizneseve, komunitetit, Këshillit Lokal për Siguri Publike, Ekipet Veprues për Siguri në Bashkësi. Këshillit të Prindërve, Zyrës për Barazi Gjinore, KBI-së dhe Komitetit për Komunitete.

Ky përfaqësim ka mundësuar që çështjet e sigurisë të trajtohen nga këndvështrime të ndryshme dhe që shqetësimet e qytetarëve të përcillen në forumet institucionale përkatëse.

VIII. REKOMANDIMET KRYESORE

1. Të vazhdohet dhe intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Komunës, Policisë së Kosovës, institucioneve arsimore, prindërve dhe institucioneve sociale.
2. Të vazhdojnë aktivitetet vetëdijesuese dhe ligjëratat në shkolla për parandalimin e dhunës, bullizmit, narkotikëve dhe sjelljeve devijante.
3. Të krijohet një mekanizëm funksional për raportim anonim të bullizmit, dhunës dhe dukurive të tjera negative në shkolla.
4. Të shqyrtohet formimi i një ekipi ndërinstitutional dhe hartimi i planit të veprimit kundër bullizmit, përfshirë bullizmin online.
5. Të vazhdojnë trajnimet për mësimdhënësit dhe aktivitetet vetëdijesuese për nxënësit dhe prindërit.
6. Të vazhdojë funksionalizimi dhe përdorimi i kamerave të sigurisë për rritjen e sigurisë dhe ndihmën në zbardhjen e rasteve.
7. Të përmirësohet ndriçimi publik dhe sinjalizimi rrugor, me prioritet pikat e identifikuara si të rrezikshme.

8. Të shqyrtohet kërkesa për vendosjen e pengesës së shtrirë pranë shkollës në fshatin Bob.
9. Të trajtohet me prioritet siguria dhe parkimi pranë çerdhes së fëmijëve.
10. Të vazhdojë zbatimi i planeve operative për sezonin veror nga Policia dhe Shërbimi i Zjarrfikësve.
11. Të shqyrtohen mundësitë për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Shërbimit të Zjarrfikësve.
12. Të intensifikohet monitorimi i orarit dhe zhurmës së lokaleve të gastronomisë gjatë natës.
13. Të ndërmerren aktivitete parandaluese për sigurinë e fëmijëve që përdorin trotinetë.
14. Të vazhdohet trajtimi me prioritet i rasteve të dëmtimit të objekteve fetare dhe bashkëpunimi me komunitetin.
15. Të përcillet zbatimi i rekomandimeve të KKSBB-së në mbledhjet pasuese dhe të kërkohen informata nga institucionet përgjegjëse për masat e ndërmarra.

IX. PËRFUNDIM

Në përfundim, puna e KKSBB-së gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ka qenë e orientuar në identifikimin e çështjeve të sigurisë, diskutimin e shqetësimeve të qytetarëve dhe koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve dhe komunitetit. Nga tri mbledhjet e mbajtura rezulton se gjendja e përgjithshme e sigurisë është vlerësuar e qetë dhe e menaxhueshme, ndërsa vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të dukurive negative, sigurisë në shkolla, trafikut rrugor, hapësirave publike dhe gatishmërisë për emergjencë.

Për periudhën e ardhshme rekomandohet që KKSBB të vazhdojë monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, të kërkojë raportim nga institucionet përgjegjëse dhe të mbajë të hapur komunikimin me qytetarët dhe përfaqësuesit e komunitetit. Kjo do të kontribuojë në rritjen e sigurisë dhe në forcimin e besimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve.

Kaçanik, 2026



Kryetari i Komunës

z.Sabedin Vishi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/ Municipality of Kačanik
Drejtoria për Buxhet dhe Financa



DATE	31 gusht 2026
REFERENCE	05-104/02-23562/26
PËR/ZA/TO:	Selajdin Troni - Kryesues Kuvendi i Komunës së Kaçanikut
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sabedin Vishi - Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Valdrin Dogani – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Fitore Vishi - Zytare Kryesore Financiare Komuna e Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Propozim-Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet 2028–2029

I nderuar,

Bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/02, e cila ofron kufijtë buxhetorë të përcaktuar nga Ministria e Financave (MF), si dhe pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore me publikun, të organizuara dhe zhvilluara nga ekzekutivi komunal, Kryetari i Komunës dërgon Propozim-Buxhetin për vitin 2027 dhe vlerësimet për periudhën afatmesme 2028–2029.

Bashkangjitur me këtë shkresë, ju dërgojmë:

Propozim-Vendimin për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028–2029, si dhe:

- Tabela 4.1 - Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës (2027–2029);
- Tabela 4.2 - Financimi vjetor i projekteve kapitale komunale (2027–2029);
- Tabela 4.3 - Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal (2027–2029); dhe
- Shënime shtesë rreth ndarjes së projeksioneve financiare.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/ Municipality of Kačanik



01 Nr. 104/02-23559/2026
Kaçanik, 31.08.2026

Në bazë të nenit 24 dhe nenit 40, paragrafit 2, pikës (b), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Qarkoreve Buxhetore të Ministrisë së Financave 2027/01 dhe 2027/02, si dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës që zhvillohet në muajin shtator 2026, të shqyrtojë dhe miratojë këtë:

PROPOZIM-VENDIM

**PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2027
DHE VLERËSIMET PËR VITET 2028-2029**

I.

Buxheti dhe vlerësimet afatmesme

Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 është në shumën prej 14,060,883.00 €, ndërkaq vlerësimet e parashikuara janë: për vitin fiskal 2028 në shumën prej 14,564,382.00 € dhe për vitin fiskal 2029 në shumën prej 15,338,067.00 €.

II.

Struktura e të hyrave buxhetore

Në strukturën e të hyrave buxhetore për vitin fiskal 2027, sipas pikës I. të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumën prej 12,857,496.00 €, me pjesëmarrje prej 91.44%, ndërsa mjetet nga të hyrat vetanake komunale janë në shumën prej 1,203,387.00 €, me pjesëmarrje prej 8.56% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

III.

Shpenzimet e përgjithshme

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin fiskal 2027 parashikohen në shumën prej 14,060,883.00 €, prej të cilave 10,628,998.00 € për shpenzime operative dhe 3,431,885.00 € për investime kapitale.

IV.

Ndarjet sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet buxhetore për vitin 2027, sipas kategorive ekonomike, parashikohen me ndarjet e mëposhtme, në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2027/02, të datës 14.08.2026, të nxjerrë nga Ministria e Financave:

1. Paga dhe shtesa – 8,096,847.00 €
2. Mallra dhe shërbime – 1,558,151.00 €
3. Shpenzime komunale – 279,000.00 €
4. Subvencione dhe transfere – 695,000.00 €
5. Investime kapitale – 3,431,885.00 €

V.
Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

VI.
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe mbetet në fuqi derisa të shfuqizohet ose ndryshohet me akt tjetër.

Kryetari i Komunës



Sabedin Vishi

Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2027–2029

Buxheti 2027–2029						
Komuna e Kaçanikut – propozimi i projekteve kapitale 2027–2029						
Nr.	Emri i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi 2027 (€)	Vlerësimi 2028 (€)	Vlerësimi 2029 (€)	Gjithsej (€)
	Gjithsej projektet kapitale (€)		3,431,885	3,789,900	4,459,839	11,681,624
	16328 Administrata		295,000	250,000	50,000	595,000
1	Rregullimi i hapësirës së jashtme të objektit komunal	20869	50,000	50,000	-	100,000
2	Ndërtimi i aneksit të objektit të administratës komunale	50993	200,000	200,000	50,000	450,000
3	Blerja e automjeteve për nevojat e administratës komunale	48210	45,000	-	-	45,000
	17528 Buxheti		180,000	295,360	445,839	921,199
4	Bashkëfinancimi i projekteve kapitale	86245	180,000	295,360	445,839	921,199
	18028 Shërbime publike – infrastruktura rugore		804,885	918,000	1,160,000	2,882,885
5	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Qemajl Guri"	20868	17,000			17,000
6	Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike në lokalitetet: Kaçanik, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Ivaqë, Strazhë dhe Doganaj	52879	100,000	150,000	150,000	400,000
7	Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari", segmenti Silkapor–Rakaj	54389	100,000	50,000	100,000	250,000
8	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Runjevë–Stagovë–Kaçanik i Vjetër	56182	102,885	150,000	190,000	442,885
9	Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Bob–Doganaj	56184	-	50,000	100,000	150,000
10	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokalitetet: Kaçanik, Bob, Runjevë, Stagovë dhe Vataj - Dubravë	1 n	85,000	148,000	200,000	433,000
11	Ndërtimi i strehimoreve për qentë endacakë	1 n	100,000	50,000	-	150,000
12	Blerja e makinerisë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike	1 n	180,000	200,000	200,000	580,000
13	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës alternative për Bëçec	1 n	70,000	100,000	-	170,000
14	Ridizajnimi dhe rregullimi i kyoçës së rrugës "Beteja e 25 Majit" në rrugën nacionale N2	1 n	50,000	20,000	70,000	140,000
15	Ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës rugore dhe publike në lokalitete të ndryshme	1 n	-	-	150,000	150,000
	47028 Bujqësia		80,000	80,000	100,000	260,000
16	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat Rekë, Soponicë dhe Doganaj	1 n	30,000	-	-	30,000
17	Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve fushore në Doganaj, Kaçanik të Vjetër dhe Vataj - Dubravë	1 n	50,000	-	-	50,000
18	Ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës bujqësore dhe rurale në lokalitete të ndryshme	1 n	-	80,000	100,000	180,000
	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik		110,000	130,000	150,000	390,000
19	Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës rekreative në Parkun e Çamit dhe në parqet e tjera publike	1 n	110,000	-	-	110,000
20	Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në destinacionet turistike të Komunës së Kaçanikut	1 n	-	130,000	150,000	280,000
	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni		795,000	970,000	1,040,000	2,805,000
21	Ndërtimi i urave mbi lumenjtë Nerodime dhe Lepenc	53279	-	100,000	200,000	300,000
22	Ndërtimi i rrugës "Reshat Shehu" me trotuar	54391	-	50,000	140,000	190,000
23	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane të Kaçanikut	55167	200,000	220,000	230,000	650,000
24	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale të Kaçanikut	55169	350,000	360,000	370,000	1,080,000
25	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugën "Hamëz Jashari" – Mejdi Dalloshi, Shaban dhe Isen Elez	56235	80,000	100,000	100,000	280,000
26	Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës "Skënderbeu" në Kaçanik	1 n	100,000	20,000	-	120,000
27	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse "Çlirimtarët" në Kaçanik të Vjetër – kthja me rrugën nacionale N2	1 n	5,000	120,000	-	125,000
28	Asfaltimi i rrugës për në pikën turistike të Krivanjevës	1 n	60,000	-	-	60,000
	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor		205,000	230,000	210,000	645,000
29	Blerja e automjettit për nevojat administrative të QKMF-së	1 n	25,000	-	-	25,000
30	Ndërtimi i parkingut prapa objektit të QKMF-së	1 n	180,000	230,000		410,000
31	Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve të kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Kaçanikut	1 n	-	-	210,000	210,000
	75636 Shërbimet sociale		-	174,000	150,000	324,000
32	Ndërtimi i objektit të OPS-së në Kaçanik	52979	-	174,000	150,000	324,000
	75637 Shërbimet rezidenciale		230,000	200,000	200,000	630,000
33	Ndërtimi i Qendrës Komunitare për ofrimin e shërbimeve rezidenciale në Kaçanik	1 n	230,000	200,000	200,000	630,000
	85028 Shërbimet kulturore		295,000	217,540	350,000	862,540
34	Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive në Kovaçec dhe Stagovë	20882	10,000	-	-	10,000
35	Ndërtimi i stadiumit të qytetit "Besnik Begunca"	45064	5,000	80,000	150,000	235,000
36	Ndërtimi i hapësirave të fitnesit të jashtëm pranë palestrës së sportive dhe përgjatë shëtitoreve	1 n	40,000	37,540	50,000	127,540
37	Ndërtimi dhe rregullimi i terrenit sportiv në Kaçanik të Vjetër	1 n	120,000	-	-	120,000
38	Ndërtimi dhe rregullimi i terrenit sportiv në Nikaj	1 n	120,000	-	-	120,000
39	Ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës për kulturë, rini dhe sport në lokalitete të ndryshme	1 n	-	100,000	150,000	250,000
	92750 Arsimi parafilior		110,000	-	-	110,000
40	Rregullimi i oborrit dhe ndërtimi i murit mbrojtës në QEAP "Agimi"	1 n	110,000	-	-	110,000
	93810 Arsimi fillor		307,000	100,000	284,000	691,000
41	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Kadri Zeka"	53269	212,000	-	-	212,000
42	Vendosja e paneleve diellore në objektet shkollore	56205	-	50,000	104,000	154,000
43	Digjitalizimi i SHFMU-ve	56223	95,000	50,000	80,000	225,000
44	Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta	1 n	-	-	100,000	100,000
	95010 Arsimi i mesëm		20,000	225,000	320,000	565,000
45	Ndërtimi i aneksit në IAAP "Feriz Guri" dhe SHML "Vëllezërit Çaka"	54433	-	150,000	190,000	340,000
46	Digjitalizimi i SHML-ve	56225	20,000	25,000	30,000	75,000
47	Vendosja e paneleve diellore në IAAP "Feriz Guri" dhe SHML "Vëllezërit Çaka"	56227	-	50,000	100,000	150,000

Vërejtje: Shumat janë paraqitur pa vende decimale.

Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2027

Buxheti 2027-2029					
Komuna e Kaçanikut – propozimi i projekteve kapitale 2027					
Nr.	Emri i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi 2027 (€)	Grant Qeveritar (€)	Të Hyra Vetanake (€)
	Gjithsej projektet kapitale (€)		3,431,885	2,753,498	678,387
	16328 Administrata		295,000	215,000	80,000
1	Rregullimi i hapësirës së jashtme të objektit komunal	20869	50,000	40,000	10,000
2	Ndërtimi i aneksit të objektit të administratës komunale	50993	200,000	140,000	60,000
3	Blerja e automjeteve për nevojat e administratës komunale	48210	45,000	35,000	10,000
	17528 Buxheti		180,000	120,000	60,000
4	Bashkëfinancimi i projekteve kapitale	86245	180,000	120,000	60,000
	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore		804,885	649,885	155,000
5	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Qemajl Guri"	20868	17,000	17,000	-
6	Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike në lokalitetet: Kaçanik, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Ivajë, Strazhë dhe Doganaj	52879	100,000	100,000	-
7	Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari", segmenti Silkapor–Rakaj	54389	100,000	80,000	20,000
8	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Runjevë–Stagovë–Kaçanik i Vjetër	56182	102,885	102,885	-
9	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokalitetet: Kaçanik, Bob, Runjevë, Stagovë dhe Vataj - Dubravë	I ri	85,000	70,000	15,000
10	Ndërtimi i strehimores për qentë endacakë	I ri	100,000	80,000	20,000
11	Blerja e makinerisë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike	I ri	180,000	100,000	80,000
12	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës alternative për Biçec	I ri	70,000	60,000	10,000
13	Ridizajnimi dhe rregullimi i kycjes së rrugës "Beteja e 25 Majit" në rrugën nacionale N2	I ri	50,000	40,000	10,000
	47028 Bujqësia		80,000	60,000	20,000
14	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat Rekë, Soponicë dhe Doganaj	I ri	30,000	25,000	5,000
15	Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve fushore në Doganaj, Kaçanik të Vjetër dhe Vataj - Dubravë	I ri	50,000	35,000	15,000
	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik		110,000	80,000	30,000
16	Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës rekreative në Parkun e Çamit dhe në parqet e tjera publike	I ri	110,000	80,000	30,000
	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni		795,000	591,613	203,387
17	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane të Kaçanikut	55167	200,000	160,000	40,000
18	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale të Kaçanikut	55169	350,000	236,613	113,387
19	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugën "Hamëz Jashari" – Mejdi Dalloshi, Shaban dhe Isen Elezi	56235	80,000	60,000	20,000
20	Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës "Skënderbeu" në Kaçanik	I ri	100,000	85,000	15,000
21	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse "Çlirimtarët" në Kaçanik të Vjetër – lidhja me rrugën nacionale N2	I ri	5,000	-	5,000
22	Asfaltimi i rrugës për në pikën turistike të Krivanjevës	I ri	60,000	50,000	10,000
	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor		205,000	160,000	45,000
23	Blerja e automjeteve për nevojat administrative të QKMF-së	I ri	25,000	20,000	5,000
24	Ndërtimi i parkingut prapa objektit të QKMF-së	I ri	180,000	140,000	40,000
	75637 Shërbimet rezidenciale		230,000	230,000	-
25	Ndërtimi i Qendrës Komunitare për ofrimin e shërbimeve rezidenciale në Kaçanik	I ri	230,000	230,000	-
	85028 Shërbimet kulturore		295,000	225,000	70,000
26	Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive në Kovaçec dhe Stagovë	20882	10,000	-	10,000
27	Ndërtimi i stadiumit të qytetit "Besnik Begunca"	45064	5,000	-	5,000
28	Ndërtimi i hapësirave të fitnesit të jashtëm pranë palestrës së sporteve dhe përgjatë shëtitoreve	I ri	40,000	30,000	10,000
29	Ndërtimi dhe rregullimi i terrenit sportiv në Kaçanik të Vjetër	I ri	120,000	100,000	20,000
30	Ndërtimi dhe rregullimi i terrenit sportiv në Nikaj	I ri	120,000	95,000	25,000
	92750 Arsimi parafilior		110,000	95,000	15,000
31	Rregullimi i oborrit dhe ndërtimi i murit mbrojtës në QEAP "Agimi"	I ri	110,000	95,000	15,000
	93810 Arsimi fillor		307,000	307,000	-
32	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Kadri Zeka"	53269	212,000	212,000	-
33	Digjitalizimi i SHFMU-ve	56223	95,000	95,000	-
	95010 Arsimi i mesëm		20,000	20,000	-
34	Digjitalizimi i SHML-ve	56225	20,000	20,000	-

Vërejtje: Shumat janë paraqitur pa vende decimale.

Tabela 4.3 Plani Afatmesëm i të hyrave totale të Buxhetit Komunal

Nr.

Përshkrimi

652 Kaçanik

2025 Buxheti

2026 Buxheti

2027 Plani

2028 Vlerësimi

2029 Vlerësimi

Të Hyrat Komunale Totale	12,592,239	13,399,753	14,060,883	14,564,382	15,338,067
Të Hyrat Vetanake	950,401	1,065,133	1,203,387	1,241,808	1,303,689
Tatimi në tokë	80,306	93,925	81,438	83,929	88,145
Tatimi në pronë	350,446	384,577	343,562	354,071	371,855
Taksat Komunale	408,649	456,631	674,000	697,000	732,000
Licencat dhe lejet	16,000	20,000	100,000	103,000	108,000
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	25,000	24,000	50,000	52,000	55,000
Taksat e pajisjeve motorike	70,000	71,000	98,000	101,000	106,000
Lejet për ndërtesa	267,537	309,631	266,000	275,000	289,000
Taksat tjera komunale	30,112	32,000	160,000	166,000	174,000
Ngarkesat Komunale	101,000	120,000	104,387	106,808	111,689
Ngarkesat rregullatore	10,000	10,000	2,000	2,000	2,200
Të hyrat nga qiraja	10,000	15,000	17,000	17,500	18,500
Bashkë-pagesat për arsim	36,000	40,000	65,000	67,000	70,000
Bashkë-pagesat për shëndetësi	5,000	5,000	15,000	15,500	16,000
Ngarkesat tjera komunale	40,000	50,000	5,387	4,808	4,989
Të hyrat tjera	10,000	10,000	-	-	-
Transferet Qeveritare	11,641,838	12,334,620	12,857,496	13,322,574	14,034,378
Granti i Përgjithshëm	5,538,386	5,656,269	6,339,269	6,645,700	7,163,197
Granti për Arsim	4,626,225	4,761,842	4,492,490	4,627,265	4,766,083
Granti për Shëndetësi	1,477,227	1,686,509	1,795,737	1,849,609	1,905,098
Financimi për Shërbime Rezidenciale	-	230,000	230,000	200,000	200,000
Financimi nga Huamarrja	-	-	-	-	-

Burimet e financimit komunal – baza 2026 dhe planifikimi 2027–2029							
	Burimi i financimit	2026 Aktual	2027 Planifikim	2028 Vlerësim	2029 Vlerësim	Ndryshimi 2027/2026	Rritja
	Granti i Përgjithshëm	5,656,269.00	6,339,269.00	6,645,700.00	7,163,197.00	683,000.00	12.08%
	Granti specifik për Arsim parauniversitar	4,761,842.00	4,492,490.00	4,627,265.00	4,766,083.00	(269,352.00)	(5.66%)
	Granti specifik për Shëndetësi primare	1,686,509.00	1,795,737.00	1,849,609.00	1,905,098.00	109,228.00	6.48%
	Financimi për shërbimet rezidenciale	230,000.00	230,000.00	200,000.00	200,000.00	0.00	–
	Gjithsej financimi qeveritar	12,334,620.00	12,857,496.00	13,322,574.00	14,034,378.00	522,876.00	4.24%
	Të hyrat vetanake komunale	1,065,133.00	1,203,387.00	1,241,808.00	1,303,689.00	138,254.00	12.98%
	Buxheti total	13,399,753.00	14,060,883.00	14,564,382.00	15,338,067.00	661,130.00	4.93%

Tabela 1. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2027

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	300,042.00	40,000.00	-	140,000.00	-	480,042.00	3.41%
2	16328 Administrata	24	214,675.00	125,000.00	40,000.00	-	295,000.00	674,675.00	4.80%
3	16528 Çështje gjinore	1	12,769.00	2,000.00	-	-	-	14,769.00	0.11%
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	226,693.00	15,000.00	-	-	-	241,693.00	1.72%
5	17528 Buxheti	11	106,351.00	15,000.00	-	-	180,000.00	301,351.00	2.14%
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	10	87,689.00	390,000.00	98,000.00	60,000.00	804,885.00	1,440,574.00	10.25%
7	18432 Zjarrfikësit dhe inspektimet	18	196,656.00	15,000.00	2,000.00	-	-	213,656.00	1.52%
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	11,942.00	1,000.00	-	-	-	12,942.00	0.09%
9	47028 Bujqësia	4	47,246.00	10,000.00	-	120,000.00	80,000.00	257,246.00	1.83%
10	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	3	31,607.00	10,000.00	-	50,000.00	110,000.00	201,607.00	1.43%
11	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni	13	138,055.00	85,000.00	-	-	795,000.00	1,018,055.00	7.24%
12	73037 Administrata (Sh)	3	34,729.00	1,000.00	-	-	-	35,729.00	0.25%
13	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	123	1,358,597.00	270,000.00	35,000.00	-	205,000.00	1,868,597.00	13.29%
14	75636 Shërbimet sociale	8	77,462.00	7,000.00	-	10,000.00	-	94,462.00	0.67%
15	75637 Shërbimet rezidenciale	-	-	-	-	-	230,000.00	230,000.00	1.64%
16	85028 Shërbimet kulturore	18	145,438.00	124,000.00	25,000.00	150,000.00	295,000.00	739,438.00	5.26%
17	92140 Administrata (A)	7	70,991.00	2,000.00	-	30,000.00	-	102,991.00	0.73%
18	92750 Arsimi parafillor – çerdhet	27	228,310.00	70,000.00	15,000.00	-	110,000.00	423,310.00	3.01%
19	93810 Arsimi fillor	404	3,827,020.00	293,849.00	44,000.00	40,000.00	307,000.00	4,511,869.00	32.09%
20	95010 Arsimi i mesëm	100	980,575.00	82,302.00	20,000.00	95,000.00	20,000.00	1,197,877.00	8.52%
	Gjithsej (€)	823	8,096,847.00	1,558,151.00	279,000.00	695,000.00	3,431,885.00	14,060,883.00	100.00%
	Struktura sipas kategorive të shpenzimeve		57.58%	11.08%	1.98%	4.94%	24.41%	100.00%	

Tabela 2. Ndryshimi i ndarjeve buxhetore 2027/2026 sipas nënprogrameve dhe kategorive ekonomike

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)
1	16028 Zyra e Kryetarit	-	(236.00)	10,000.00	-	-	-	9,764.00	1.48%
2	16328 Administrata	-	2,950.00	30,000.00	15,000.00	-	171,000.00	218,950.00	33.12%
3	16528 Çështje gjinore	-	580.00	(3,000.00)	-	-	-	(2,420.00)	-0.37%
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	-	6,239.00	-	-	-	-	6,239.00	0.94%
5	17528 Buxheti	-	(7,882.00)	-	-	-	30,000.00	22,118.00	3.35%
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	-	(6,755.00)	20,000.00	10,000.00	-	138,574.00	161,819.00	24.48%
